



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 64, Datë 08.04.2020

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEGA-G” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5 pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 27, datë 10.02.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GEGA -G” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/9, datë 11.02.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GEGA - G” sh.p.k..
- Me shkresën nr. 502 prot, datë 17.02.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 502/1 Prot, datë 25.02.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k, është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.08.2001, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

- Aplikimi i shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin nr. 12039 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan nga i cili rezulton se ndaj shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., është vendosur masa gjobë, për kundërshtimin e së cilës shoqëria ka paraqitur ankim në gjykatën kompetente.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “GEGA -G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Shoqëria në përfundim të procesit gjyqësor me objekt shfuqizimin e Aktit Administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. 7647/7 Prot, datë 29.03.2016, të depozitujë në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.
3. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**